

## LIGJ

Nr.9148, date 30.10.2003

### PER RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT TE VITIT 2002 TE KONVENTES NR.155 TE ORGANIZATES NDERKOMBETARE TE PUNES "PER SIGURINE NE PUNE, SHENDETIN DHE MJEDISIN E PUNES, 1981"

Ne mbeshtetje te neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 te Kushtetutes, me propozimin e Keshillit te Ministrave,

### KUVENDI I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

#### V E N D O S I:

##### Neni 1

Ratifikohet Protokollin e vitit 2002 i Konventes nr.155 te Organizates Nderkombetare te Punes "Per sigurine ne pune, shendetin dhe mjedisin e punes, 1981".

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr.4008, date 18.11.2003 te Presidentit te Republikes se Shqiperise, Alfred Moisiu

### PROTOKOLL PER KONVENTEN E SIGURISE DHE SHENDETIT NE PUNE, 1981

Konferenca e pergjithshme e Organizates Nderkombetare te Punes:  
duke u mbledhur ne Gjeneve nga organi drejtues i zyres Nderkombetare te Punes dhe duke zhvilluar sesionin e 90-te me, 3 korrik 2002;  
duke pare dispozitat e nenit 11 te Konventes se sigurise dhe shendetit ne pune, 1981 (tani e tutje quhet "Konventa"), e cila parashikon ne menyre te vecante:  
"Per zbatimin e politikave se permendur ne nenin 4 te Konventes, organi ose organet kompetente sigurojne qe funksionet e meposhtme te kryhen ne menyre progresive:

.....

c) caktimi dhe zbatimi i procedurave per njoftimin e aksidenteve dhe te semundjeve profesionale nga punecthesisit dhe, kur eshte e pershtatshme, nga institutet e sigurimeve dhe subjekteve te tjera te interesuara drejtperdrejt, si dhe hartimi i statistikave vjetore, ne lidhje me aksidentet dhe semundjet profesionale;

e) botimi cdo vit i informacionit mbi masat e marra ne pajtim me politiken e permendur ne nenin 4 te kesaj Konvente dhe mbi aksidentet ne pune, semundjet profesionale dhe demtimet e tjera te shendetit qe jane shkaktuar gjate ose ne lidhje me punen";

duke pasur parasysh nevojën e forcimit të procedurave të regjistrimit dhe njoftimit për aksidentet dhe semundjet profesionale dhe nxitjes së harmonizimit të sistemit të regjistrimit me qëllimin e identifikimit të shkaqeve të tyre dhe marrjen e masave parandaluese;

duke vendosur për aprovimin e propozimeve të caktuara në lidhje me regjistrimin dhe njoftimin e aksidenteve dhe semundjeve profesionale, që është pika e pestë e punimeve të sesionit;

duke vendosur që këto propozime të marrin formën e një protokollit të Konventës për sigurinë dhe shëndetin në punë, 1981,

aprovon me 20 qershor 2002 protokollin e mëposhtëm, i cili mund të citohet si protokollin e vitit 2002 të Konventës së sigurisë dhe shëndetit në punë, 1981.

## I. PERKUFIZIME

### Neni 1

Për qëllimin e këtij protokollit:

- a) Termi "aksident në punë" mbulon një ndodhi që shkaktohet nga ose gjatë punës, e cila mund të rezultojë në dëmtim fatal ose jofatal.
- b) Termi "semundje profesionale" mbulon çdo semundje që shkaktohet si rezultat i ekspozimit kundër rreziqeve që rrjedhin nga aktiviteti i punës.
- c) Termi "ndodhi e rrezikshme" mbulon një ngjarje lehtësisht të identifikueshme sipas perkufizimit të ligjeve dhe rregulloreve vendase, me potencialin për t'i shkaktuar një dëmtim ose semundje një personi në punë ose publikut.
- d) Termi "aksident në rrugë" mbulon një aksident që shkakton vdekjen ose dëmtimin e personit, që ndodh në rrugën ndërmjet vendit të punës dhe
  - i) vendbanimit të parë ose të dytë të punëtorit;
  - ii) vendit ku punëtori zakonisht ushqehet;
  - iii) vendit ku punëtori zakonisht merr pagesën e tij ose të saj.

## II. SISTEMET E REGJISTRIMIT DHE NJOFTIMIT

### Neni 2

Organi kompetent, me anë të ligjeve dhe rregulloreve ose ndonjë metode tjetër në pajtim me kushtet dhe praktikën vendase dhe në konsultim me organizatat me përfaqësues të punëdhënësve dhe punëtorëve, përcaktojnë dhe rishikojnë periodikisht kërkesat dhe procedurat për:

- a) regjistrimin e aksidenteve në punë, semundjeve profesionale dhe, sipas rastit, ndodhite e rrezikshme, aksidentet në rrugë dhe rastet e dyshuara të semundjeve profesionale;
- b) njoftimin e aksidenteve në punë, semundjeve profesionale dhe, sipas rastit, ndodhite e rrezikshme, aksidentet në rrugë dhe rastet e dyshuara të semundjeve profesionale.

### Neni 3

Kerkesat dhe procedurat per regjistrimin rregullojne:

a) pergjegjesine e punedhenesit per:

i) regjistrimin e aksidenteve ne pune, semundjeve profesionale dhe, sipas rastit, ndodhite e

rrezikshme, aksidentet ne rruge dhe rastet e dyshuara te semundjeve profesionale;

(ii) dhenien e informacionit te pershtatshem punetoreve dhe perfaqesuesve te tyre ne lidhje

me sistemin e regjistrimit;

(iii) sigurimin e mbajtjes se pershtatshme te ketyre te dhenave dhe perdorimin e tyre per marrjen e masave parandaluese;

(iv) menjanimin e marrjes se masave hakmarrese ose disiplinore kunder nje punetori qe raporton nje aksident ne pune, semundje profesionale, ndodhi te rrezikshme, aksident ne rruge ose rast te dyshuar te semundjes profesionale;

b) informacionin qe duhet te regjistrohet;

c) periudhen e mbajtjes se ketyre te dhenave;

d) masat per te siguruar konfidencialitetin e te dhenave personale dhe mjekesore ne zoterim te punedhenesit, ne pajtim me ligjet dhe rregulloret, kushtet dhe praktikat vendase.

### Neni 4

Kerkesat dhe procedurat per njoftimin parashikojne:

a) pergjegjesine e punedhenesve per:

i) njoftimin e organeve kompetente ose organeve te tjera te caktuara ne lidhje me aksidentet ne pune, semundjet profesionale dhe, sipas rastit, ndodhite e rrezikshme, aksidentet ne rruge dhe rastet e dyshuara te semundjeve profesionale dhe

ii) dhenien e informacionit te pershtatshem punetoreve dhe perfaqesuesve te tyre ne lidhje me rastet e njoftuara;

b) kur eshte rasti, masat per njoftimin e aksidenteve ne pune dhe semundjeve profesionale nga institutet e sigurimeve, sherbimet mjekesore ne pune, mjeket dhe organe te tjera qe jane drejtperdrejt te interesuara;

c) kriteret sipas se cilave duhet te njoftohen aksidentet ne pune, semundjet profesionale dhe, sipas rastit, ndodhite e rrezikshme, aksidentet ne rruge dhe rastet e dyshuara te semundjeve profesionale;

d) afatet e njoftimit.

### Neni 5

Njoftimi perfshin te dhena mbi:

a) ndermarrjen, subjektin ose punedhenesin;

b) nese eshte e zbatueshme, personat e demtuar dhe natyren e demtimeve ose semundjes;

c) vendin e punes, rrethanat e aksidentit ose ndodhine e rrezikshme dhe, ne rastin e nje semundjeje profesionale, rrethanat e ekspozimit karshi rrezikimit te shendetit.

### III. STATISTIKAT KOMBETARE

#### Neni 6

Çdo shtet anetar që ratifikon këte protokoll, bazuar mbi njoftimet dhe informacionin tjetër të disponueshëm, boton çdo vit statistika, të cilat përpilohen në mënyrë të tillë që të përfaqësojnë të gjithë vendin në lidhje me aksidentet në punë, semundjet profesionale dhe, sipas rastit, ndodhite e rrezikshme dhe aksidentet në rrugë, si dhe një analizë të tyre.

#### Neni 7

Statistikat përpilohen në pajtim me skemat e klasifikimit, që janë në pajtim me skemat perkatese të fundit, nderkombetare, që janë përpiluar nën kujdesin e Organizatës Nderkombetare të Punes ose organizata të tjera nderkombetare.

### IV. DISPOZITA TE FUNDIT

#### Neni 8

1. Një anetar mund ta ratifikojë këte protokoll në të njëjtën kohë ose në çdo moment pas ratifikimit të Konventës, duke ia njoftuar ratifikimin formal Drejtorit të Përgjithshëm të Zyres Nderkombetare të Punes për regjistrimin.
2. Protokollin hyn në fuqi 12 muaj pas datës në të cilën janë regjistruar ratifikimet për dy anetare nga drejtori i përgjithshëm. Pas kësaj, për një anetar ky protokoll hyn në fuqi 12 muaj pas datës së regjistrimit të ratifikimit nga drejtori i përgjithshëm dhe Konventa është detyruese për anetarin përkatës, duke shtuar edhe nenet 1 deri 7 të këtij protokoll.

#### Neni 9

1. Një anetar që ka ratifikuar këte protokoll mund ta denoncojë atë kurdoherë që Konventa është e hapur për t'u denoncuar sipas nenit 25, nëpërmjet një akti drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Zyres Nderkombetare të Punes për regjistrim.
2. Denoncimi i Konventës sipas nenit 25 të saj nga një anetar që ka ratifikuar këte protokoll shkakton ipso jure denoncimin e këtij protokoll.
3. Çdo denoncim i këtij protokoll, në pajtim me paragrafet 1 ose 2 të këtij neni, nuk hyn në fuqi deri një vit pas datës në të cilën është regjistruar.

#### Neni 10

1. Drejtori i Përgjithshëm i Zyres Nderkombetare të Punes njofton të gjithë anetaret e Organizatës Nderkombetare të Punes për regjistrimin e të gjitha verifikimeve dhe akteve të denoncimit të njoftuar nga anetaret e organizatës.

2. Kur ben njoftimin e anetareve te organizates ne lidhje me regjistrimin e ratifikimit te dyte, drejtori i pergjithshem terheq vemendjen e anetareve te organizates per daten kur ky protokoll hyn ne fuqi.

Neni 11

Drejtori i Pergjithshem i Zyres Nderkombetare te Punes njofton Sekretarin e Pergjithshem te Kombeve te Bashkuara, ne lidhje me regjistrimin sipas nenit 102 te Kartes se Kombeve te Bashkuara, te gjitha hollesite e ratifikimeve dhe akteve te denoncimit te regjistruara nga drejtori i pergjithshem sipas dispozitave te neneve te mesiperme.

Neni 12

Versionet e tekstit ne anglisht dhe frengjisht te ketij protokolli jane njesoj autentike. Teksti i mesiperme eshte teksti autentik i protokollit, i miratuar rregullisht nga konferenca e pergjithshme e Organizates Nderkombetare te Punes gjate sesionit te 90, te mbajtur ne Gjeneve dhe deklaruar e mbyllur me 20 qershor 2002. Ne deshmi te kesaj, ne i vume firmat tona me 21.6.2002.